



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

Nr. 360-48421 dt. 27.09 2023



Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, neni 20 i Ligjit Nr 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Vendimi Nr.01 -020/04-6514 dt.02.02.2023, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 27.09.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Projekt Rregullores për Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit

Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i Projekt Rregullores për Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2023-2025, të hartuar nga Grupi Punues Komunal.

Neni 2

Programi ka për qëllim identifikimin e rasteve, ndihmë për sigurim të banimit për kategori të ndryshme qytetarësh në nevojë, për banim të përkohshëm.

Neni 3

Pas aprovimit të këtij vendimi në Kuvendin e Komunës, për zbatimin e tij do të përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari

A r s y e t i m

Më Ligjin Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, të dala nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim Social 2019-2021, rregullohet çështja e Banimit të Përkohshëm Social, në mënyrë që t'u mundësohet zgjidhja e nevojave të banimit familjeve të caktuara të cilat nuk kanë mundësi ekonomike ta zgjidhin këtë problem.

Hartimi i Programit për Banimin Social 2023-2025, do të mundësoj kushtet për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë të vështirë ta bëjnë një gjë të tillë.

Me aprovimin e Programit trevjeçar për Banimin Social, synojmë plotësimin e obligimeve ligjore dhe zbatimin e këtyre politikave të banimit në Komunën e Drenasit të ndërlidhet me procesin e integritetit evropian dhe me kriteret për anëtarësimin në BE duke respektuar Konventat Evropiane, Kartën Sociale dhe Deklaratën për të Drejtat e Njeriut.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Nr./ Prot. No. 02
Breg Prot. No. 5709-2/23
Data: 10.10.23
No. 1

PRISHTINË / A

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data: 10.10.2023

Nr. i Lendes: 020-741/12
Vlera:

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë
Lloji i aktit:	Vendimi 02 Nr.360-48431 për miratimin e Projekt Rregullores për Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit.

I nderuar Kryetar Lladrovci,
I nderuar Kryesues Hajdari,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 02.10.2023 ka pranuar nga MAPL Vendimin 02 Nr.360-48431 për miratimin e Projekt Rregullores për Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 27.09.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

K O N F I R M O N

Vendimin 02 Nr.360-48431 për miratimin e Projekt Rregullores për Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, datë 27.09.2023.

A R S Y E T I M I

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të Vendimit 02 Nr.360-48431 për miratimin e Projekt Rregullores për Programin Komunal Tre Vjeçar për Banim për periudhën 2023-2025 për Komunën e Glllogocit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Glllogocit, është në harmoni me Ligjin Nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

